

## **THIRRJE PËR APLIKIM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 50, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” kërkon të rekrutojë një ekspertit të jashtëm të kualifikuar në fushën e komunikimit për asistencë në përmirësimin e fushatës informuese për publikun, ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve, zgjerimin e kanaleve të komunikimit, etj. në mënyrë që procesi i mbylljes së programeve (kanaleve) analoge dhe kalimi në transmetimet numerike, të jetë sa më i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët.

## **TERMAT E REFERENCËS**

### **Objektivi dhe qëllimi**

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike përcakton AMA-n si autoritetin përgjegjës për realizimin e fushatës së informimit të publikut. Procesi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike është jo vetëm një proces prioritar për të gjitha vendet evropiane, pjesë e BE ose jo, por mbi të gjitha është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare. Për sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive për të qënë sa më afër publikut dhe për ta bërë sa më të kuptueshëm kalimin e transmetimeve nga analoge në numerike ka filluar në muajin shtator të vitit 2015 fushatën e informimit për këtë proces kaq të rendesishëm, duke realizuar spote, njoftime me titra, broshura informuese, fletpalosje, ngritjen e nje strukture call center, hapjen e nje llogarie ne rrjetin social facebook, numra telefoni ne dispozicion.

Megjithëse AMA ka filluar procesin e informimit për publikun që prej muajit shtator të vitit 2015, më 10 shtator 2018 me fikjen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës, rezultoi se popullata ende nuk ishte e njohur me teknologjinë e dekoderit dhe mënyrën e lidhjes së tij për të përfutur transmetimet digjitale.

Në këto kushte, me qëllim që kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike për qarkun e Tiranës dhe Durrësit, por edhe në qarqet në vijim ku pritet të ndodhë digjitalizimi, të realizohet në mënyrë sa më efikase, duke shmugur problematikat e hasura deri tani, me qëllim që qytetarët të kuptojnë sa më mirë informacionin dhe detajet e nevojshme, në mënyrë të veçantë ato teknike, që prekin drejtpërdrejt përdorimin e pajisjeve apo aksesorëve shtëpiakë të nevojshëm për të mundësuar marrjen e sinjalit numerik dhe eventualisht shikimin e kanaleve dixhitale, kërkojmë:

-përmirësimin e fushatës informuese për publikun, përfshirë edhe ndryshimin e përmbajtjes së spoteve informuese, njoftimeve, zgjerimin e kanaleve të komunikimit, etj.

### **Detyrat që duhet të realizojë eksperti**

Eksperti duhet të:

1. Asistojë stafin e AMA-s në hartimin e mesazheve të komunikimit që do të përcillen te një audiencë e specializuar dhe publiku i gjerë;
2. Hartimi i materialeve të sloganit, mesazheve kyçe dhe përmbajtjeve të tjera vizuale që do të duhen për fushatën *outdoor* që do të ndërmerren në kuadër të informimit të publikut për procesin e digjitalizimit;
3. Mbështetja e aktiviteteve të fushatës, vizibiliteti mediatik dhe marketingun e AMA-s për fushatën e informimit të publikut për procesin e digjitalizimit;

4. Angazhimi dhe mbështetja e stafit të AMA-s në hartimin e përmbajtjes së mesazheve (informacioneve) dhe me shpërndarjen e informacionit në mediumet e komunikimit;
5. Idejimi, konceptimi dhe prodhimi (prodhimi – përmes agjencive të specializuara) i videospoteve që do të duhen, me qëllim rritjen e vizibilitetit të fushatës së informimit të publikut për procesin e digjitalizimit, me qëllim përcjelljen e mesazheve te qytetarët;

### **Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm**

1. Të zotërojë diplomën e shkollës së lartë në shkencë shoqërore. Kualifikimet në fushën e komunikimit do të përbëjnë avantazh;
2. Të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë në fushën e komunikimit;
3. Të jetë marrë me punë të ngjashme;
4. Eksperiencat në këtë fushë me institucione ndërkombëtare do të përbëjnë avantazh;
5. Të jetë shtetas shqiptar;
6. Të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si ekspert në fushën e komunikimit;

### **Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:**

1. Diploma e shkollës së lartë në shkencë shoqërore;
2. Kualifikime të tjera në shkencë shoqërore;
3. Librezën e punës ku të vertetohen vitet e eksperiencës;
4. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme;
5. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme me institucione ndërkombëtare;
6. Jetëshkrimi;
7. Ekstrakti nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
8. Kopje ID/Pasaportë;

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

1. Diploma e shkollës së lartë në shkencë shoqërore; 20 pikë
2. Kualifikime të tjera në shkencë shoqërore; 10 pikë
3. Librezën e punës ku të vertetohen vitet e eksperiencës; 30 pikë
4. Dokumentacioni për punë të ngjashme; 20 pikë
5. Dokumentacioni për punë të ngjashme me institucione ndërkombëtare; 10 pikë
6. Jetëshkrimi; 10 pikë

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

**Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë**

**APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 7 NËNTOR 2018**